

Vjenë, 9.1.2021

Teste të rregullta, pa pagesë dhe që mund t'i kryejnë vetë për nxënësit dhe nxënëset në Austri – bmbwf.gv.at/selbsttest

Të dashur prindër dhe persona me të drejtë kujdestarie (Erziehungsberechtigte)!

Fakti që në Austri filluan vaksinimet kundër virusit korona na lejon të gjithëve “të marrim pak frymë”. Njëkohësisht, kemi edhe disa muaj para nesh gjatë të cilëve virusi do të vazhdojë të ekzistojë. E di që këto ditë prisni sidomos një plan afatgjatë. Për fat të keq numri i personave të infektuar, megjithë mbylljen e plotë (lockdown), aktualisht nuk po zhvillohet në mënyrë të tillë që do të bënte të mundur një planifikim më të gjatë se një javë. Megjithatë, duke u nisur nga situata e sotme, llogaris, siç kam thënë edhe më parë, që mësimi për fëmijën tuaj prej datës 18.1.2021 të mbahet në shkollë, pra me prezencë – por për këtë nuk ka garanci.

Sigurisht që aktiviteti i ardhshëm shkollor do të shoqërohet prej masave higjienike të deritanishme. Por me **vënien në përdorim të një procedure të re dhe të rregullt testimi** do të jetë e mundur për ne që me mbështetjen tuaj të forcojmë edhe njëherë sigurinë nëpër shkolla. Prandaj po ju drejtohem me këtë letër.

Teste jo të mundimshme dhe që mund t'i bëjnë vetë për nxënësit dhe nxënëset – Rezultati për 15 minuta

Nga momenti i rihapjes së shkollave deri në pushimet e semestrit të gjitha shkollave në Austri do t'ju vihen në dispozicion rreth 5 milionë teste që mund të bëhen vetë për nxënësit e nxënëset. Testi ka **dy përparësi kryesore**: Tamponi duhet futur vetëm në pjesën e përparme të vrimës së hundës dhe nuk ka nevojë për të marrë material nga gryka – për këtë arsye këtë test mund ta bëjë kushdo vetë pa vështirësi. Pas 15 minutash del rezultati, pra është diçka e ngjashme me një test shtatzanie. Ashtu si dhe testet e tjerë të shpejtë edhe ky test është sidomos i përshtatshëm për të dëshmuar një ngarkesë të lartë virusale. Kjo do të thotë që personat, të cilët janë shumë ngjitës, të identifikohen menjëherë.

Nxënësit dhe nxënëset e shkollës fillore dhe të shkollave speciale (Sonderschule) do ta marrin testin dhe udhëzimin përkatës me vete për ta bërë atë në shtëpi, të gjithë nxënësit dhe nxënëset e tjera do të testohen nën mbikqyrje në shkollë

Nëse fëmija juaj ndjek shkollën fillore ose atë speciale (Sonderschule) do ta merrni testin dhe udhëzimin përkatës në shkollën që ndjek fëmija. Fëmija mund ta bëjë pastaj testin në shtëpi nën mbikqyrjen tuaj. Të gjithë nxënësit dhe nxënëset e tjera do ta bëjnë testin në shkollë, gjithashtu nën mbikqyrje (pedagogë, mjekë dhe mjeke të shkollës).

Testim i rregullt të paktën një herë në javë

Për të mundësuar ngritjen me anë të testeve të një rrjeti të gjerë dhe afatgjatë sigurimi, kuptohet që testimet do të kryhen në intervale të rregullta. Fillimisht testimet do të bëhen një herë në javë, duke synuar që të bëhen dy herë në javë.

Deklaratë Miratimi prej prindërve për moshat nën 14 vjeç për testet në shkollë

Në rast se fëmija juaj është në moshën prej 10 deri në 14 vjeç dhe duhet ta bëjë testin në shkollë, ai ka nevojë për një Deklaratë Miratimi nga ana juaj si dokument. Deklaratën e Miratimit mund ta merrni në shkollë ose mund ta shkarkoni në faqen tonë të internetit. Ju lutemi ta dorëzoni atë, pasi ta keni nënshkruar, në shkollën ku shkon fëmija juaj.

Si funksionon testi? Video udhëzuese te bmbwf.gv.at/selbsttest

Në faqen e internetit bmbwf.gv.at/selbsttest gjeni një video të shkurtër dhe një udhëzim të thjeshtë që pasqyron kryerjen e testit hap pas hapi. Po në këtë faqe mund ta shkarkoni edhe një broshurë informuese për pyetjet rreth testit – edhe në shumë gjuhë të tjera.

Testet që kryhen vetë janë vullnetare dhe falas

Testet që mund t'i bësh vetë janë një ofertë gratis për ju dhe fëmijën tuaj. Nuk ka pasoja, nëse nuk e pranoni. Por sa më shumë fëmijë të marrin pjesë në këtë testim të rregullt, aq më e sigurt është jeta e përditshme në shkollë për fëmijën tuaj – dhe për të tjerët. Unë ju lutem, bëjeni bashkë me fëmijën tuaj dhe motivojeni fëmijën tuaj që të marrë pjesë!

Juaji



Heinz Faßmann

Ministër federal për Arsimin, Shkencën dhe Kërkimin Shkencor

Përkthim i broshurës informuese përkatëse në gjuhën gjermane për prindërit e personat me të drejtë kujdestarie me titullin: “Antigen-Selbsttests für Schülerinnen und Schüler“

Kopertina:

Teste antigen që mund të bëhen vetë për nxënësit e nxënëset bmbwf.gv.at/selbsttest

- ✓ Tamponi futet vetëm 2 cm në hundë
- ✓ i shkurtër dhe pa dhimbje
- ✓ rezultati për 15 minuta
- ✓ një herë në javë
- ✓ mbi baza vullnetare
- ✓ gratis

Përmbajtja:

Shumë të nderuar prindër, shumë të nderuar persona me të drejtë kujdestarie (Erziehungsberechtigte),

edhe pse vaksinimet kundër virusit korona në Austri kanë filluar, virusi do të na shoqërojë edhe disa muaj në aktivitetin shkollor. Por me përdorimin e rregullt nëpër shkolla të testeve të reja antigen që mund t'i bësh vetë, mund ta rrisim edhe njëherë jashtëzakonisht shumë sigurinë në jetën e përditshme në shkollë. Kusht për këtë është pjesëmarrja e gjallë e nxënësve dhe nxënësve. Prandaj: Ju lutemi motivojeni fëmijën tuaj që të marrë pjesë në testimet e reja, përgjithësisht vullnetare! Sepse çka vlen është: SË BASHKU në luftën kundër virusit!

Kjo broshurë shpjegon me një vështrim se çfarë duhet të dini ju dhe fëmija juaj për testet antigen që bëhen vetë.

Ministria Federale për Arsimin, Shkencën dhe Kërkimin Shkencor (BMBWF)

Çfarë është testi antigen që mund ta bësh vetë?

Testi antigen që mund ta bësh vetë, si shumë teste të tjerë të shpejtë, mund ta sqarojë brenda 15 minutash nëse personi i testuar në momentin e testimit është i infektuar me korona apo jo.

Testi që bëhet vetë, me shpejtësinë dhe përdorimin e thjeshtë të tij, mund të japë në aktivitetin shkollor një ndihmesë të rëndësishme për të penguar përhapjen e pandemisë. E reja në këtë test të shpejtë është që ai mund të bëhet vetë nga personi që do të testohet.

Si shpjegohet që personi që do të testohet mund ta bëjë vetë testin?

Testi antigen, të cilin mund ta bësh vetë, ka kundërt testeve të tjerë të shpejtë një përparësi të rëndësishme në përdorim: tamponi nuk duhet të futet thellë në pjesën e sipërme të

vrimes së hundës, por vetëm 2 cm thellë në çdo vrimë hunde. Ky përdorim i thjeshtë bën të mundur që edhe një joprofesionist të mund ta bëjë vetë testin.

Ku mund ta bëjë këtë test fëmija im?

Nëse fëmija juaj ndjek **shkollën fillore** ose **shkollën speciale** (Sonderschule), ju do ta merrni direkt nga shkolla kompletin e testit me gjithë udhëzimin dhe mund ta bëni **testin në shtëpi**. Në rastet kur fëmija juaj ndjek shkollën e mesme (Mittelschule), ciklin e ulët të gjimnazit (AHS-Unterstufe) ose një shkollë të mesme apo të lartë, testin mund ta bëjë në shkollë.

Në ç' mënyrë zhvillohet testi?

Te bmbwf.gv.at/selbsttest gjeni një video udhëzuese dhe një udhëzues të thjeshtë për kryerjen e testit.

Si bëhet testi në shkollë?

Në shkollë testet për nxënësit e një klase mund të bëhen në klasë brenda rreth 45 minutave. Gjatë testimit dhoma ajroset. Nxënësit mund të ndahen në dy grupe, A dhe B. Në fillim testohet grupi A, grupi B vazhdon të mbajë maskën. Pastaj testohet grupi B, grupi A mban maskën. Në përgjithësi, shkollat mund të vendosin vetë ku duan t'i bëjnë testimet – për shembull e mundshme është edhe një palestër. E rëndësishme është që dhoma të ajroset mirë, të sigurohet distanca ndaj personit që po testohet dhe – siç është e zakonshme aktualisht prej ciklit të parë të arsimit të mesëm – të mbahet maska prej të gjithë atyre që nuk po testohen në atë moment.

Sa shpesh bëhet testi në fjalë?

Këto testime do të ofrohen fillimisht një herë në javë, ndërsa për periudha afatgjata dy herë në javë.

Çfarë kushtesh duhet të plotësohen që fëmija juaj të lejohet ta bëjë testin në shkollë?

Për fëmijët në moshën nën 14 vjeç nevojitet një Deklaratë Miratimi prej prindërve, me qëllim që fëmija i tyre të lejohet ta bëjë testin në shkollë. Prindërit e nxënësve dhe nxënëseve të shkollës së mesme ose të ciklit të ulët të gjimnazit mund ta marrin formularin e Deklaratës së Miratimit në shkollë ose ta shkarkojnë këtu: bmbwf.gv.at/selbsttest. Ju lutemi ta dorëzoni në shkollë pasi ta keni nënshkruar.

Çfarë ndodh nëse testi del pozitiv?

Në rast se fëmija juaj e ka bërë testin në shtëpi ju lutemi të kontaktoni numrin e telefonit 1450.

Në rast se fëmija juaj ka marrë një rezultat pozitiv të testit në shkollë, kontaktoni shkollën. Kjo informon gjithashtu numrin telefonik 1450 dhe Institucionin Shëndetësor lokal.

A zhvillohet testimi mbi baza vullnetare dhe falas?

Po. Nuk ka asnjë pasojë për ju dhe fëmijën tuaj, nëse e refuzoni testin. Por sa më shumë fëmijë ta bëjnë atë, aq më e sigurt është jeta e përditshme në shkollë për çdo fëmijë.

Keni pyetje?

bmbwf.gv.at/selbsttest

Korona-Hotline e Ministrisë Federale për Arsimin, Shkencën dhe Kërkimin Shkencor (BMBWF):

0800/21 65 95

Shërbimi për qytetarët i BMBWF:

0800/20 56 76

Impressum:

Pronari i medias, botues dhe kryeredaktor:

Bundesministerium für Bildung, Wissenschaft und Forschung (Ministria Federale për Arsimin, Shkencën dhe Kërkimin Shkencor)

Minoritenplatz 5, 1010 Wien

Tel. +43 1 531 20-0

Përgatiti: BMBWF

Fotot: Credits BMBWF

Vjenë, janar 2021

bmbwf.gv.at